



Buxhetimi me Pjesëmarrje në Shqipëri

Konteksti i projektit

Banka Botërore në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane (IKU) dhe dy organizata të tjera shqiptare: NACSS dhe Co-Plan ndërmori iniciativa për të forcuar pjesëmarrjen qytetare në procesin e qeverisjes vendore në Shqipëri duke:

- ngritur aftësitë drejtuese të zyrtareve të qeverisjes vendore e të shoqërisë civile për t'u angazhuar në këshillime që janë të fokusuar dhe me objektiva të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve komunitare dhe
- në baza pilot të prezantojë mekanizmat afatshkurter dhe afatgjate për institucionalizimin e zërit të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Objektivi afatgjate është të krijojë mundësi për përfshirje sociale në vendimmarrjet publike

Aktiviteti

Aktiviteti i PPBP teston mekanizma që kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje në procesin e buxhetimit lokal në Shqipëri. Rezultati që kërkon të arrijë metoda e buxhetimit me pjesëmarrje është t'u sigurojë qytetarëve mundësinë për të marre pjese në procesin e vendimmarrjes gjatë planifikimit financiar të qeverisjes vendore dhe të testojë mekanizmat që rritin këtë pjesëmarrje. Përfaqesues nga Ministria e Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit (MPVD), Ministria e Financave (MF), Shoqata e Bashkive Shqiptare, Shoqata e Komunave Shqiptare, personeli i Bankes Botërore dhe OJF të tjera moren pjesë në Procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje (PBP) nëpërmjet një komiteti drejtues që u krijua për të monitoruar dhe për të përhapur mësimet e nxjerra nga keto aktivitete. Projekti Pilot u implementua në bashkëpunim me tri OJF lokale. Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) po menaxhon në përgjithësi procesin dhe po harton të gjithë komponentët kryesore për të tre njësite vendore të Kasharit, Baldushkut dhe Prrenjasit. IKU ka pasur nje eksperience te vazhdueshme ne lehtesimin e dialogut midis qytetarëve dhe qeverise vendore në Shqipëri.

Fazat

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.



- 1) Hartimi i buxhetit nëpërmjet bashkëpunimit Qytetar – Qeveri Vendore
- 2) Monitorimi i Buxhetit nga Qytetarët dhe dhenia e informacionit nga ana e qeverisë vendore për shpenzimet në buxhet.

PBP hyri në fazën e dytë - monitorimi i Buxhetit nga Qytetarët dhe dhënia e informacionit nga ana e qeverisë vendore për shpenzimet në buxhet – gjatë periudhës Shkurt – Qershor 2005. Para fillimit të fazës së dytë konsulentet e IKU-it organizuan një sërë aktivitete në mënyrë që të rrisnin kapacitetet lokale, rishikuan dhe përmiresuan materialet e trajnimeve që ishin hartuar gjatë fazës së parë të PBP. Ndërkohë po hartohet dhe një manual në shqip për zbatimin e buxhetimit me pjesëmarrje në Shqipëri dhe dy bashkitë dhe dy komunat po zbatojnë buxhetimin me pjesëmarrje për vitin 2006.

Monitorimi i Zbatimit të Buxhetit dhe Punëve Publike

Në bazë të aktiviteteve të përcaktuara për fazën e monitorimit, grupi i monitorimit: (i) mori pjesë në procedurën e prokurimit, (ii) monitoroi dy herë zbatimin e projekteve të infrastrukturës/punëve publike, dhe (iii) bëri vlerësimin në fund të projektit (dorezimi i punëve publike). Për çdo aktivitet grupi i monitorimit përpiloi një raport. Gjatë kësaj faze IKU u fokusua më shumë në dhënie të asistencës së nevojshme gjatë përzgjedhjes së delegatëve që do të monitoronin projektet për infrastrukturën/punët publike në tre qeveritë vendore duke punuar ngushtë me grupet qytetare dhe supervisorët, për të siguruar

cilesinë e pritshme të punëve publike si dhe asistimin në procedurat e dorezimit. Si rezultat i pjesëmarrjes aktive të grupit të monitorimit në Kashar, fondet për një nga investimet (rikonstruksioni i rruges Mezez – Fushe) u ulën me 1.453.000 leke (14.530 US\$). Kjo tregon efikasitetin e manaxhimit të fondeve publike kur kemi një proces transparent për prokurimet. Kjo është e rëndësishme që të përmendet nëse marim në konsideratë që rikonstruksioni i qendrës shëndetsore në Baldushk kushton vetëm 1.500.000 lekë (15.000 US\$).

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Banka Botërore

KOHËZGJATIA:

20 Prill 2005 – Prill 2006

PËRFITUESIT:

- ✓ Komuna Kashar
- ✓ Komuna Prrenjas
- ✓ Komuna Baldushk

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al